

Zbatimi i Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

“Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin e UMM/UM në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër dhe Sarandë.

Periudha e monitorimit: Shtator 2014 - Maj 2015

Hartuan raportin:

Av. Av. Iris Aliaj

Av. Aurela Bozo

Prof.Dr.Av. Aurela Anastasi

Kontribuan për përgatitjen e raportit monitoruesit në rrethe:

- 1. Av. Adena Dervishaj, Vlorë**
- 2. Rezarta Agolli, Durrës**
- 3. Irena Marjani, Sarandë**
- 4. Kristi Kola, Shkodër**
- 5. Servete Gera, Dibër**
- 6. Av. Soela Kurti dhe Elisa Gripshi, Juriste, Elbasan**
- 7. Elona Arolli, Pogradec**

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje dhe metodologjia e raportit

Kreu I- Profili social i viktimës dhe dhunuesit

Gjinia e palës paditëse

Profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare

Profili Social i dhunuesit/es në marrëdhëniet familjare

Larmishmëria e marrëdhënieve të viktimës me dhunuesin

Kreu i II-Efektiviteti i Mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje

Objekti i kërkesë padive për lëshimin e UMM/UM

Disponimi i gjykatave të rretheve gjyqësore objekt monitorimi

Pushimi i gjykimit

Shkaqet e pushimit të gjykimit

Organet ku është denoncuar dhuna në familje

Të dhëna mbi çështje të tjera që janë duke u ndjekur nga palët

Shoqërimi i viktimës nga policia gjatë gjykimit

Si është kryer denoncimi i dhunës në familje?

Përfaqësimi me avokat i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare

Kohëzgjatja e UMM/UM

Zbatimi i afateve procedurale për lëshimin e UMM/UM

Ku janë bazuar gjykata e rretheve gjyqësore në dhënien e vendimit?

Padia publike

Roli i Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të Dhunës në Familje

Referimi i vendimit të UMM/UM për ekzekutim

Kreu i III-Konkluzione dhe Rekomandime

Bibliografia

Hyrje

Metodologjia

Ky raport monitorues prezanton gjetje të rëndësishme në lidhje me zbatimin e Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar në rrethet gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër, dhe Sarandë.

Përgatitja dhe botimi i raportit monitorues janë mundësuar në kuadrin e zbatimit të projektit “Mbrojtja dhe promovimi i çështjeve për të drejtat e grave nëpërmjet ndërhyrjes në 7 rrethe në Shqipëri”, financuar nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Raporti prezanton gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt leshimin e UMM/UM në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër, dhe Sarandë.

Janë monitoruar 103 vendime gjyqësore të lëshimit të UMM/UM në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, 106 vendime gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, 51 vendime gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, 38 vendime gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, 27 vendime gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, 30 vendime gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, 188 vendime gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Janë monitoruar 543 vendime gjyqësore në total. Periudha e monitorimit është Shtator 2014 – Maj 2015.

Puna për kryerjen e monitorimit konsistoi në përgatitjen dhe plotësimin e një skede monitoruese, të përgatitur nga avokatë ekspertë të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, një organizatë jofitimprurëse që punon prej vitit 1996 për rritjen e aksesit të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare në sistemin e drejtësisë.

Skeda monitoruese përcaktoi çështjet objekt monitorimi. Monitoruesit në rrethe plotësuan skedën monitoruese me të dhëna nga vendimet gjyqësore të monitoruara për çështjet dhe gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi.

Monitorimet në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër, dhe Sarandë janë kryer nga juristë të organizatave monitoruese, Forum i Gruas Elbasan, Gruaja tek Gruaja Shkodër, Qendra Psiko Sociale Vatra Vlorë, Jona në Sarandë, Shoqata e Grave me probleme sociale Durrës, Argitra në Peshkopi, Unë Gruaja Pogradec. Në rastet e mungesës së juristëve të punësuar janë angazhuar bashkëpunëtorë juristë pranë këtyre organizatave.

Bazuar në të dhënat që kanë rezultuar nga skedat monitoruese të plotësuara nga monitoruesit në rrethe është përgatitur raporti monitorues. Për përgatitjen e të dhënave kanë kontribuar edhe anëtarë të skuadrave probono të ngritura pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare ¹.

Praktika e organizatave jo fitimprurëse që kryen monitorimin, në mbështetje të viktimave të dhunës në familje ka ndihmuar në identifikimin dhe analizën e problemeve në raport. Janë

¹ Falenderojmë anëtarët e skuadrës pro bono Inklida Allka, Vilma Spahiu, Vilma Davidhi, Adriana Kalemaj, Lirie Dina, Xhulia Mulla, Jona Kota, Donald Tafilaj, Iva Pendavinji, Viarta Pulla.

përgatitur raporte monitoruese për secilin rreth objekt monitorimi si edhe është përgatitur një raport i integruar.

Përgatitja e raporteve të monitorimit për çdo rreth është konsideruar si një mjet që mund të përdoret në nivel lokal nga organizatat jofitimprurëse dhe aktorët e tjerë lokalë për të lobuar për përmirësimin e zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar dhe rritjen e efektivitetit të zbatimit të tij në favor të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Raporti monitorues i integruar paraqet interes për të matur arritjet, për të identifikuar nevojat për përmirësime, për të analizuar tendencat, për t’ju referuar në mënyrë krahasuese gjetjeve të rretheve të ndryshme gjyqësore, etj.

Raporti monitorues është konsultuar me përfaqësues të institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm që kontribuojnë në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje në Tiranë dhe në rrethet e monitoruara. Sygjerimet dhe mendimet e ndara me pjesëmarrësit në këto aktivitete janë pasqyruar në draft raport dhe kanë kontribuar për ti dhënë draft raportit formën finale.

Disa nga vështirësitë e hasura në procesin e monitorimit janë: vështirësia për të patur akses në vendimet gjyqësore/dosjet/rastet, mungesa e të dhënave të plota, vonesa në arësyetim të vendimeve dhe plotesimin e dosjeve, etj.

Në përfundim, kryerja e monitorimeve të vazhdueshme mbi zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar ndihmon për rishikimin e vazhdueshëm të efektivitetit të mjeteve ligjore që ai ofron urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrin të mbrojtjes, përmbushjes së detyrimeve ligjore nga aktorët përgjegjës në nivel qendror dhe vendor dhe përcaktimin e nevojave për ndërhyrje.

Raporti paraqet interes edhe në lidhje me matjen e punës së anëtarëve të Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në rrethet objekt monitorimi. Raporti me gjetjet që prezanton përbën një mjet lobimi i cili mund të përdoret nga organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe aktorë të tjerë aktivë në këtë çështje.

Problematikat e evidentuara gjatë monitorimit përbëjnë një platformë pune edhe për organizatat monitoruese.

Kryerja e monitorimeve dhe studimeve mbi efektivitetin e zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje përbën edhe një nga kërkesat që burojnë nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Një nga aktet më të rëndësishme të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë e cila kërkon nga shtetet palë studime dhe monitorime të vazhdueshme të legjislacionit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ratifikuar me ligjin nr.104/2012.

Kreu I- Profili social i viktimës dhe dhunuesit

Të dhëna në lidhje me profile dhe aspekte sociale të dhunës në familje

• **GJINIA E PALËS PADITËSE**

Një koncept me mjaft interes në këtë konventë është koncepti “dhunë gjinore kundër grave”. Dhuna gjinore është dhuna që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale. Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, konsideron dhunën në familje si një ndër format më serioze të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave. Konventa njeh dhunën ndaj grave si një shprehje të marrëdhënieve të pushtetit, historikisht të pabarabartë ndërmjet grave dhe burrave.

Studimet dhe raportet reflektojnë përballjen e grave me dhunën në marrëdhëniet familjare në përqindje të larta krahasuar me burrat.

Të dhënat nga monitorimi i vendimeve gjyqësore në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Shkodër, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër, Sarandë dhe Durrës tregojnë se në përqindjen më të lartë të rasteve janë gratë që i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor me një kërkesë për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin të mbrojtjes.

Këto të dhëna tregojnë qartë se dhuna e ushtruar në marrëdhëniet familjare vazhdon të mbetet dhunë me bazë gjinore dhe shpreh qartë pushtetin e një gjinie ndaj gjinisë tjetër në familje. Të dhënat tregojnë qartë se në përqindjen më të lartë të rasteve janë gratë që i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor me një kërkesë për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin të mbrojtjes, duke kërkuar kështu parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje bazuar në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

Tabela në vijim paraqet të dhëna mbi gjininë e palës paditëse, viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare në gjykatat objekt monitorimi.

Gjinia e palës paditëse

<i>Gjykatat e rretheve gjyqësore</i>	<i>Pala paditëse/Grua</i>
<i>Shkodër</i>	77.2 %
<i>Elbasan</i>	84 %
<i>Pogradec</i>	86.3 %
<i>Vlorë</i>	79 %
<i>Dibër</i>	85.2 %
<i>Sarandë</i>	80 %
<i>Durrës</i>	77.7 %

Tabela nr.1

Në 77.2 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në 84 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 86.3 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në 79 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në 85.2 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, në 80 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe në 77.7 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, gjinia e palës paditëse është grua.

Kjo gjetje mbështetet edhe nga të dhëna zyrtare referuar burimeve të tjera, si psh të dhënavë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe raporteve monitoruese të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Raporte monitoruese të zbatimit të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të kryera nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare tregojnë se në përqindjen më të lartë të rasteve, pala paditëse në kërkesat për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes nga gjykata janë gra dhe vajza.

Kështu, referuar në një prej raporteve monitoruese mbi zbatimin e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare për periudhën objekt monitorimi 30.04.2008-01.06.2009, rezulton se në 448 vendime për lëshimin e Urdhrave të Mbrojtjes të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 91.51% e kërkesve të Urdhrit të Mbrojtjes janë gra dhe në 8.49 % janë burra. Pra, gruaja rezulton pjestarja më e dhunuar e familjes.

Në 93.34 % të vendimeve të monitoruara nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare , me objekt lëshimin e UMM/UM të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 01.06.2009-01.06.2010, paditëset janë gra dhe në 6.65% të rasteve paditësat janë burra.

PROFILI SOCIAL I VIKTIMËS SË DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin e UMM/UM në gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi kanë rezultuar disa gjetje paraprake në lidhje me profilin social të palëve ndërgjyqëse viktimës/dhunuesit si edhe në lidhje me aksesin e viktimave të dhunës në familje në sistem si edhe efektivitetin e sistemit në mbështetje të viktimave.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër,

Profili social i një viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare rezulton të jetë kryesisht,

- ▶ një grua me arsim të mesëm,
- ▶ e martuar,
- ▶ e papunë,
- ▶ e grupmoshës 31-40 vjeç,
- ▶ me vendbanim në qytet,
- ▶ me 2 fëmijë,
- ▶ e dhunuar në marrëdhëniet bashkëshortore,
- ▶ e përballur me format e dhunës fizike, psikologjike, ekonomike,
- ▶ me persona të tretë të dëmtuar, fëmijët.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ky profil social ka këto karakteristika kryesisht:

- ▶ një grua me arsim 8-9 vjeçar,
- ▶ e martuar,
- ▶ e papunë,
- ▶ e grupmoshës 18-30 dhe 31-40 në përqindje të njëjtë
- ▶ me vendbanim në qytet,
- ▶ me 2 fëmijë,
- ▶ e dhunuar në marrëdhëniet bashkëshortore,
- ▶ e përballur me format e dhunës fizike, psikologjike,
- ▶ nuk ka të dhëna për personat e tretë të dëmtuar.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ky profil ka këto karakteristika, kryesisht

- ▶ një grua,
- ▶ me arsim 8-9 vjeçar,
- ▶ e papunë,
- ▶ me banim në qytet,
- ▶ e martuar,
- ▶ e grupmoshës 31-40 vjeç,
- ▶ me dy fëmijë;
- ▶ e përballur me format e dhunës fizike, psikologjike, ekonomike,
- ▶ me persona të tretë të dëmtuar, fëmijët.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në lidhje me profilin social të viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare ai është kryesisht,

- ▶ një grua,
- ▶ e papunë,
- ▶ e dhunuar në marrëdhëniet bashkëshortore,
- ▶ e grupmoshës 18-30, e ndjekur nga grupmosha 31-40 vjeç,
- ▶ me vendbanim në qytet e ndjekur nga viktima që jeton në fshat,
- ▶ me dy fëmijë,
- ▶ përballet me dhunë fizike dhe psikologjike.

Në lidhje me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, profili social i një viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare kryesisht është një grua,

- ▶ me banim kryesisht në qytet,
- ▶ e martuar,
- ▶ e dhunuar në marrëdhëniet bashkëshortore,
- ▶ e grupmoshës 31-40 vjeç,

- ▶ me dy fëmijë;
- ▶ përballet me dhunë fizike dhe psikologjike.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, profili social i një viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare është kryesisht,

- ▶ një grua,
- ▶ kryesisht me arsim 8-9 vjeçar,
- ▶ e papunë,
- ▶ e martuar,
- ▶ e grupmoshës 18-30 vjeç dhe 41-50 vjeç,
- ▶ me vendbanim në fshat,
- ▶ me dy fëmijë e ndjekur nga me tre fëmijë,
- ▶ e dhunuar në marrëdhëniet bashkëshortore,
- ▶ e përballur me dhunë fizike dhe psikologjike,

Profili social i një viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare që ka rezultuar nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të lëshimit të UMM/UM, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë është:

- ▶ kryesisht një grua,
- ▶ me arsim 8-9 vjeçar,
- ▶ e papunë,
- ▶ e martuar,
- ▶ e grupmoshës 31-40 vjeç,
- ▶ me banim në qytet dhe në po të njëjtën përqindje me banim në fshat,
- ▶ me 2 fëmijë,
- ▶ e dhunuar në marrëdhëniet bashkëshortore,
- ▶ e përballur me dhunë fizike dhe psikologjike
- ▶ ku fëmijët janë persona të tretë të dëmtuar nga dhuna e ushtruar në marrëdhëniet familjare;

Gjetje të përbashkëta në lidhje me profilin social të viktimës.

Nga analiza e profileve sociale të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, në gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi dallojmë disa karakteristika të përbashkëta. Kështu në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, në përqindjen më të lartë të rasteve viktime e dhunës në marrëdhëniet familjare është një grua, e paarsimuar dhe e papunë. Viktimat e dhunës në familje janë përballur me forma të ndryshme të dhunës fizike, psikologjike dhe të kombinuar. Rezulton se fëmijët dhe pjestarë të tjerë të familjes janë persona të tretë të dëmtuar nga dhuna e ushtruar në marrëdhëniet familjare.

Në lidhje me vendbanimin e viktimës na rezulton se në përqindjen më të lartë të rasteve viktimat janë me banim në qytet por në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Sarandë viktime është me banim në qytet dhe fshat dhe Dibër viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë me banim në fshat. Na rezulton edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec një përqindje e

lartë e rasteve të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare me banim në fshat, megjithëse renditen në vendin e dytë pas viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare me banim në qytet.

Gjetjet në lidhje me format e dhunës në familje mbështeten edhe nga të dhënat zyrtare në nivel kombëtar. Kështu referuar Vrojtimin Kombëtar me bazë popullatën, 2013 të INSTAT rezulton se 53.7 % e grave përjetojnë aktualisht të gjitha llojet e dhunës në familje, 52.8 % përjetojnë aktualisht dhunë psikologjike, 14.7 % përjetojnë aktualisht dhunë fizike dhe 16.2 % përjetojnë aktualisht si dhunë fizike ashtu edhe dhunë seksuale. Në 53.7 % të grave që pohojnë se përjetojnë aktualisht të gjitha llojet e dhunës në familje përfshihen të gjitha format e saj si dhuna fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike, e asistuar, e kombinuar, morale, etj.

PROFILI SOCIAL I DHUNUESIT/ES

Analiza dhe studimi i profilit social të dhunuesit që ushtron dhunë ndaj pjestarëve të familjes gjithashtu paraqet rëndësi. Për të ravijëzuar këtë profil po i referohemi të dhënave që rezultojnë nga monitorimi i vendimeve gjyqësore në gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi.

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhunuesi është kryesisht një burrë me arsim 8-9 vjeçar, i papunë, i martuar, i grupmoshës 41-50 vjeç ndjekur nga grupmosha 31-40 vjeç, me banim në qytet, pa fëmijë.

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka rezultuar se dhunuesi/ja është kryesisht me arsim i mesëm, i papunë, i martuar, i grupmoshës 31-40 vjeç, me banim në qytet, me dy fëmijë;

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka rezultuar se dhunuesi/ja është kryesisht me arsim 8-9 vjeçar, i papunë, i martuar, i grupmoshës 31-40 vjeç dhe 41-50 vjeç, me banim në fshat, me 2 fëmijë;

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka rezultuar se dhunuesi/ja është kryesisht me arsim 8-9 vjeçar, i martuar, i punësuar, i grupmoshës 41-50 vjeç, me banim në qytet, me 2 fëmijë;

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka rezultuar se dhunuesi/ja është kryesisht me arsim 8-9 vjeçar, i papunë, i martuar, i grupmoshës 31-40 vjeç, me banim në qytet, me 2 fëmijë.

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec rezulton se dhunuesi/ja është kryesisht i papunë, i martuar, i grupmoshës 31-40 vjeç, me banim në fshat, me 2 fëmijë;

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezulton se dhunuesi/ja është kryesisht i martuar, i grupmoshës 41-50 vjeç ndjekur nga grupmosha 31-40 vjeç, me banim në qytet, me 2 fëmijë;

Arsimi i ulët, papunësia, grupmosha 31-40 dhe 41-50 vjeç, numri i fëmijëve janë karakteristika të përbashkëta për profilin social të dhunuesëve në gjykatat objekt monitorimi.

Alkoli, xhelozia, shpenzimi i kohës dhe parave në lojërat e fatit, mosmarrëveshjet për shkak të çështjeve pasurore dhe çështjeve të pronësisë; jetesa e përbashkët e ish bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës, mosmarrëveshjet dhe konfliktet familjare që shoqërojnë marrëdhëniet në familje, zgjidhja e martesës, tradhëtia bashkëshortore, personaliteti i dhunshëm dhe gjendja psikologjike e rënduar dhunuesit e shoqërojnë dhunën në marrëdhëniet familjare. Ato kanë një dinamikë që i bën të shfaqen herë si shkak i dhunës në këto marrëdhënie dhe herë si pasojë e dhunës së ushtruar në marrëdhëniet familjare.

LARMISHMËRIA E MARRËDHËNIEVE TË VIKTIMËS ME DHUNUESIN

Pavarësisht se dhuna në familje është më shumë e pranishme në marrëdhëniet mes bashkëshortëve, ish bashkëshortëve, bashkëjetuesëve, ajo është prezente edhe në marrëdhëniet midis ish bashkëjetuesëve, prind/fëmijë, nusë/vjehërr dhe dhëndër/vjehërr, vëlla/motër, kunata, ish kunata, midis vëllezërve, xhaxha/nip.

Nga monitorimi kanë rezultuar këto të dhëna në lidhje me prezencën e dhunës në familje në marrëdhëniet midis bashkëshortëve, ish bashkëshortëve, bashkëjetuesëve dhe ish bashkëjetuesëve.

<i>Gjykatat e rretheve gjyqësore</i>	<i>Bashkëshortë</i>	<i>Ish bashkëshortë</i>	<i>Bashkëjetues</i>	<i>Ish bashkëjetues</i>
<i>Shkodër</i>	<i>42.7 %</i>	<i>7.8 %</i>	<i>2.9 %</i>	<i>-</i>
<i>Elbasan</i>	<i>54.7 %</i>	<i>12.3 %</i>	<i>3.8 %</i>	<i>-</i>
<i>Pogradec</i>	<i>51 %</i>	<i>9.8 %</i>	<i>5.9 %</i>	<i>2 %</i>
<i>Vlorë</i>	<i>55.3 %</i>	<i>7.9 %</i>	<i>-</i>	<i>-</i>
<i>Dibër</i>	<i>44.4 %</i>	<i>-</i>	<i>11.1 %</i>	<i>3.7 %</i>
<i>Sarandë</i>	<i>63.3 %</i>	<i>-</i>	<i>10 %</i>	<i>-</i>
<i>Durrës</i>	<i>50.5 %</i>	<i>8 %</i>	<i>6.9 %</i>	<i>1.6 %</i>

Tabela nr.2

Nga monitorimi konstatohet një rritje e numrit të rasteve të ushtrimit të dhunës në familje midis prindërve dhe fëmijëve si edhe prindërve dhe nuseve të djemve.

Kjo larmishmëri marrëdhëniesh tregon nevojën sociale për të zgjeruar konceptin e pjestarëve të familjes siç u parashikua në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare', i ndryshuar.

Kjo larmishmëri dëshmon rritjen e nivelit të informacionit të komunitetit mbi pjestarët e familjes që gëzojnë mbrojtje nga dhuna në familje dhe mund të përdorin dy mjetet ligjore urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrin e mbrojtjes.

KREU I II-EFEKTIVITETI I MBROJTJES PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

OBJEKTI I KËRKESË PADIVE PËR LËSHIMIN E UMM/UM

Lëshimi i UMM, Vërtetimi i UMM, Lëshimi i UM, Ndërprerja e efekteve të UM, Ndryshimi i UM, kanë përbërë objektin e kërkesë padive drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore objekt monitorimi.

Objekti	GjRrGj Shkodër	GjRr.Gj Elbasan	GjRr.Gj Dibër	GjRr.Gj Vlorë	GjRr.Gj Pogradec	GjRr.Gj Durrës	GjRr.Gj Sarandë	Totali	%
Lëshim i UMM	73	38	19	34	36	185	23	408	75.1 %
Vërtetim i UMM	24	26	-	1	-	-	7	58	10.7 %
Lëshim UM	3	42	8	3	15	3	-	74	13.6 %
Ndërprerja e UM	2	-	-	-	-	-	-	2	0.4 %
Ndryshimi i UM	1	-	-	-	-	-	-	1	0.2 %
Totali	103	106	27	38	51	188	30	543	100 %

Tabela nr.3

Nga monitorimi rezulton se në 75.1 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara në total në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi është kërkuar lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes duke reflektuar qartë se viktimat janë përballur me dhunë në marrëdhëniet familjare dhe mbrojtja e kërkuar prej tyre ka qenë e menjëhershme. Kjo tendencë konstatohet shumë e qartë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në të cilën nga 188 kërkesa të paraqitura pranë kësaj gjykate me objekt lëshimin e UMM/UM në 185 prej tyre objekti ka qenë lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Vetëm në 13.6 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara në total në gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi, objekti i kërkesë padisë ka qenë lëshimi i urdhrin të mbrojtjes. Nga tabela konstatohet se vetëm në 10.7 % të vendimeve të monitoruara është kërkuar vërtetimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes duke reflektuar qartë faktin se pikërisht në këtë moment viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare mund të tërhiqet nga procesi. Është kërkuar nga pala paditëse ndërprerja e efekteve të urdhrin të mbrojtjes vetëm në 0.4 % të rasteve dhe në 0.2 % të rasteve është kërkuar ndryshimi i Urdhrin të mbrojtjes.

DISPONIMI I GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE OBJEKT MONITORIMI

Në lidhje me disponimin e gjykatës, nga monitorimi ka rezultuar se në numrin më të lartë të rasteve në 361 raste ose në 66.5 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara në total, gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi nuk kanë hezitur të lëshojnë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes për viktimat. Është vendosur pranim i pjesshëm i kërkesë padisë nga Gjykatat e rretheve gjyqësore në 3.9 % të rasteve. Në këto raste, gjykatat e rretheve gjyqësore nuk kanë vendosur të përfshijnë në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes të gjitha masat urgjente të kërkuara nga pala paditëse por vetëm disa prej tyre që këto gjykata i kanë çmuar të arësyeshme. Ne mendojmë se edhe në këto raste, gjykatat e rretheve gjyqësore kanë pranuar kërkesën sepse objekt i kërkesës ka qenë lëshimi i UMM/UM dhe jo marrja e masave të caktuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Masat mbrojtëse të kërkuara në padi duhet të trajtohen nga gjykata si një opinion i paditëses/it dhe jo si objekt i kërkesëpadisë, me qëllim që gjyqtari i çështjes të përzgjedh masat më efikase për mbrojtjen e viktimave, duke marrë edhe masa të tjera veç atyre të parashtruara nga paditësja/i. Në 21 raste ose në 3.9 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara, gjykatat e rretheve gjyqësore kanë vendosur të rrëzojnë kërkesën për lëshimin e UMM/UM. Nga vendimet gjyqësore dhe analiza e shkaqeve me monitoruesit në rrethe na ka rezultuar se ndër shkaqet kryesore të rrëzimit të kërkesës me objekt lëshimin e UMM/UM është mungesa e provave. Në 4 raste ose në 0.4 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara Gjykata ka vendosur të refuzojë lëshimin e urdhrin të mbrojtjes. Numri i rasteve për të cilat gjykata ka vendosur pushimin e çështjes është 136 ose 25 % e 543 vendimeve gjyqësore të monitoruara në total, në të gjitha gjykatat objekt monitorimi.

Vendimi gjykatës	I	Shkodër	Elbasan	Dibër	Vlorë	Pogradec	Durrës	Sarandë	Totali	%
Pranim kërkesë		61	49	10	36	6	182	17	361	66.5 %
Pranim i pjesshëm	i	1	16	-	2	-	1	1	21	3.9 %
Pushim gjykimi		35	35	14	-	37	3	12	136	25 %
Rrëzim kërkesë		3	6	3	-	8	1	-	21	3.9 %
Refuzim		3	-	-	-	-	1	-	4	0.7 %
Totali		103	106	27	38	51	188	30	543	100 %

Tabela nr.4

PUSHIMI I GJYKIMIT

Në lidhje me vendimet e pushimit të gjykimit, për çështjet me objekt lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrin të mbrojtjes ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Shkodër ka vendosur pushimin e gjykimit në 33.9 % të rasteve², Gjakata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur pushimin e gjykimit në 33 % të rasteve, Gjakata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur pushimin e gjykimit në 51.9 % të rasteve, Gjakata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur vetëm pranimin e kërkesë padisë dhe pranimin e pjesshëm të saj, Gjakata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur pushimin e gjykimit në 72.5 % të rasteve, Gjakata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur pushimin e gjykimit në 1.6 % të rasteve dhe Gjakata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur pushimin e gjykimit për çështjet objekt monitorimi në 40 % të rasteve.

Pushim Gjykimi	Shkodër	Elbasan	Dibër	Vlorë	Pogradec	Durrës	Sarandë	Total
%	33.9 %	33 %	51.9 %	-	72.5 %	1.6 %	40 %	25 %
nr	35	35	14	-	37	3	12	136
Totali i vendimeve gjyqësore	103	106	27	38	51	188	30	543

Tabela nr.5

Nga monitorimi ka rezultuar se në total në 25 % të vendimeve të monitoruara është vendosur pushimi i gjykimit. Cilat janë shkaqet kryesore të marrjes së këtij vendimi nga gjykatat e rretheve gjyqësore. Tabela në vijim pasqyron shkaqet e pushimit të çështjes nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

SHKAQET E PUSHIMIT TË GJYKIMIT.

Pushim Gjykimi	Shkodër	Elbasan	Dibër	Vlorë	Pogradec	Durrës	Sarandë
Mosparaqitje e paditëses/it	34.3 %	51.4 %	7.1 %	-	70.3 %	66.7 %	91.7 %
Heqje dorë e paditëses/it	65.7 %	48.6 %	92.9 %	-	29.7 %	33.3 %	8.3 %

Tabela nr.6

² Pushimet e gjykimit në gjykatat e rretheve gjyqësore duhen parë në raport me numrin e vendimeve të monitoruara në secilën gjykatë objekt monitorimi. Për këtë arsye në këtë tabelë së bashku me vendimet e pushimit kemi paraqitur edhe numrin e vendimeve gjyqësore të monitoruara me objekt lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes në Gjakatat e Rretheve Gjyqësore Shkodër, Elbasan, Dibër, Vlorë, Pogradec, Durrës dhe Sarandë.

Dy janë shkaqet kryesore të pushimit të gjykimit, mosparaqitja e paditësit/ses dhe heqja dorë nga gjykimi i çështjes e paditësit/es. Kështu në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër është vendosur pushimi i gjykimit në 34.3 % të rasteve për shkak të mosparaqitjes së paditësit/es në seancën gjyqësore dhe në 65.7 % të rasteve është vendosur pushimi i gjykimit për arsye se paditësja/i është paraqitur në seancën gjyqësore dhe ka pohuar para gjykatës se heq dorë nga shqyrtimi i çështjes.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur pushimi i gjykimit në 51.4 % të rasteve për shkak të mosparaqitjes së paditëses/it dhe në 48.6 % të rasteve për shkak të heqjes dorë të paditëses/it nga gjykimi i çështjes.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër është vendosur pushimi i gjykimit për mos paraqitje të paditëses/it në 7.1 % të rasteve dhe është pushuar gjykimi në 92.9 % të rasteve për shkak se paditësja/i kanë hequr dorë nga gjykimi i çështjes.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në të gjitha vendimet gjyqësore të monitoruara ka rezultuar se Gjykata ka lëshuar UMM/UM, duke mos pasur asnjë vendim pushim gjykimi.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit në 70.3 % të rasteve për shkak të mosparaqitjes së paditëses/it dhe në 29.7 % të rasteve për shkak se paditësja/i ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit në 66.7 % të rasteve për shkak të mos paraqitjes së paditëses/it dhe në 33.3 % për shkak të heqjes dorë të paditëses/it nga gjykimi i çështjes.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit në 91.7 % të rasteve për shkak të mosparaqitjes së paditëses/it dhe në 8.3 % të rasteve për shkak se paditësja/i ka hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes.

Ky monitorim na ofron të dhëna që na mundësojnë krahasimin e gjetjeve jo vetëm midis gjykatave të monitoruara por edhe me monitorimet e kryera në gjykatat e rretheve të tjera gjyqësore. Kështu, nga të dhënat që rezultojnë nga monitorimet e kryera nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare mbi zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", kjo përqindje e vendimeve të pushimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitet 2011-2012 është rreth 60%.

Të dhënat na mundësojnë një reflektim mbi disa nga arësyet e përqindjes më të ulët të vendimeve të pushimit në gjykatat objekt monitorimi.

Së pari, mendojmë se funksionimi i Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkitë përkatëse dhe puna e aktorëve, anëtarë të këtij mekanizmi ka dhënë efekte pozitive që kanë rezultuar në përdorimin më efektiv të mjeteve ligjore civile, bazuar në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

Së dyti, kjo lidhet me një ndërgjegjësim dhe besim në rritje të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare në rrethe tek sistemi dhe mundësitë mbështetëse dhe mbrojtëse që ai ofron për viktimat.

Së treti, aktorë shumë aktivë që kanë kontribuar në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë organizatat jofitimprurëse. Përmes ofrimit të këtyre shërbimeve, viktimat janë ndier më të sigurta për ti shkuar procesit deri në fund.

Së katërti, ne mendojmë se kjo tendencë e rënies së numrit të vendimeve të pushimit në rrethe lidhet edhe me efektet parandaluese të zbatimit të ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

Pavarësisht, tendencës në rënie të numrit të vendimeve të pushimit në rrethe, vendimet e pushimit janë një fakt shqetësues që kërkon vëmendjen e të gjithë aktorëve. Në vështrim të parë mosparaqitja e palës paditëse dhe heqja dorë nga gjykimi i çështjes duket se lidhen vetëm me viktimën por e vërteta është ndryshe. Vendimet e pushimit janë një tregues matës i punës së të gjithë aktorëve. Mos paraqitja e palës paditëse ose heqja dorë nga gjykimi i çështjes prej viktimës mund të lidhet edhe me kushtet e vështira social ekonomike të familjes, të cilat e mbajnë një viktimë të dhunës në familje brenda ciklit, pa e lejuar të dalë prej saj, të denoncojë dhe të gëzojë mbrojtje.

Viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare mund të marrë këtë vendim për të kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, edhe si rezultat i frikës së një dhune edhe më ekstreme të ushtruar nga dhunuesi dhe pasigurisë së saj se, do t'i ofrohet mbrojtja e duhur gjatë kësaj periudhe.

Deklarata e viktimës madhore/mitur së dhunës në marrëdhëniet familjare se heq dorë nga gjykimi, ose se ajo është pajtuar me dhunuesin kërkon një vëmendje të veçantë nga gjykata, avokatët, psikologët e punonjësit social dhe profesionistët e tjerë. Ofrimi i shërbimit psikologjik dhe ligjor për viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për lëshimin e UMM/UM do të përbënte një mbështetje të rëndësishme dhe do të rriste ndërgjegjësimin e viktimës në lidhje me ciklet e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe rolin parandalues të mjeteve ligjore që parashikohen në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

Ofrimi i një mbështetje të qëndrueshme të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare me avokat, psikolog ose punonjës social do ti ofronte viktimës mbështetje dhe do të rriste besimin e saj për të përdorur mjetet ligjore për parandalim dhe mbrojtje.

ORGANET KU ËSHTË DENONCUAR DHUNA NË FAMILJE

- ▶ Organi i policisë qëndron në vendin e parë, ndër organet ku viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë denoncuar dhunën e pësuar. Pse?

Së pari, pavarësisht se nuk mungojnë rastet kur avokatet e organizatave jofitimprurëse ngrenë shqetësime në lidhje me reagimin efektiv të policisë ndaj viktimave të dhunës në familje, rezulton një rritje e besimit të komunitetit, në mënyrë të veçantë viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare tek organi i policisë.

Së dyti, denoncimi i rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në polici lidhet edhe me faktin se ky organ vazhdon të perceptohet nga viktima si organi që ofron siguri për viktimën e dhunës në familje gjatë procesit gjyqësor të lëshimit të shqyrtimit të kërkesë padisë për lëshimin e UMM/UM dhe ekzekutimit të tij.

Së treti, organi i policisë mundëson prova për dhunën e pësuar nga viktimat duke ja lehtësuar procesin e të provuarit në gjykatë, në çështjet me objekt lëshimin e UMM/UM.

Nga monitorimi ka rezultuar një tendencë e raportimit në rritje të dhunës në marrëdhëniet familjare pranë organizatave jofitimprurëse që adresojnë dhunën me bazë gjinore, në mënyrë të veçantë dhunën në marrëdhëniet familjare në rrethet objekt monitorimi si Forumi i Gruas Elbasan, Gruaja tek Gruaja dhe organizata të tjera në Shkodër, Qendra psiko sociale Vatra dhe organizata të tjera në Vlorë;

TË DHËNA MBI ÇËSHTJE TË TJERA QË JANË DUKE U NDJEKUR NGA PALËT

Nga monitorimi ka rezultuar se në 3.7 % të rasteve palët kanë në proces çështje të tjera gjyqësore, në 10 vendime palët janë duke zgjidhur martesën ligjore, në 7 raste i padituri akuzohet për kryerjen e veprës penale dhunë në familje dhe çështja është në gjykim, në 2 raste i padituri akuzohet për kryerjen e veprës penale dhunë në familje por çështja është në fazën e hetimit në prokurori dhe vetëm në një rast palët janë në proces të pjestimit të pasurisë. Shoqërimi i çështjeve me objekt lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes me çështje të tjera gjyqësore si zgjidhja e martesës dhe rregullimi i pasojave të saj si edhe çështje të ndryshme pronësie, apo akuza për dhunë në familje si vepër penale rrisin mosmarrëveshjet dhe tensionin mes palëve duke çuar shpesh në përshkallëzim të dhunës në marrëdhëniet familjare.

SHOQËRIMI I VIKTIMËS NGA POLICIA GJATË GJYKIMIT

Shoqërimi i viktimës nga policia në gjykatë ose në shërbime sociale, qendra shëndetësore etj kur vlerësohet se jeta e viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është në rrezik është një nga detyrat me të cilat e ngarkon organin e policisë ligji nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. Kështu nga monitorimi i vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Elbasan ka rezultuar se në 1 % të rasteve policia e ka shoqëruar viktimën në Gjykatë pasi viktimat ka qenë i burgosur, por nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Në 10 % të rasteve të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka rezultuar se policia e ka shoqëruar viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare në gjykatë, kur ka cmuar se jeta e viktimës është në rrezik. Rezulton se viktimat në një rast në Vlorë është shoqëruar nga Policia pasi ka marrë vendimin.

Nuk rezultojnë raste të shoqërimit të viktimës nga policia në gjykatat e rretheve gjyqësore Dibër, Pogradec, Durrës dhe Sarandë.

Shoqërimi i viktimës nga policia në gjykatë ose shërbime

Shoqërimi i viktimës nga policia	Shkodër	Elbasan	Dibër	Vlorë	Pogradec	Durrës	Sarandë
13%	1 %	1%	-	1 %	-	-	10 %

Tabela nr.7

SI ËSHTË KRYER DENONCIMI I DHUNËS NË FAMILJE?

Në lidhje me subjektet që kanë kryer denoncimin, ka rezultuar nga monitorimi se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Dibër, Pogradec, Durrës, Sarandë ka qenë vetë viktima që ka denoncuar dhunën e pësuar në organin e policisë në të gjitha vendimet gjyqësore të monitoruara. Ndërsa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në 1 % të vendimeve të monitoruara ka rezultuar se ka qenë djali i viktimës i cili ka lajmëruar policinë dhe në po të njëjtën përqindje babai i viktimës ka denoncuar dhunën. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në 2.6 % të vendimeve ka qenë nëna e viktimës që ka denoncuar dhunën në polici.

Këto gjetje tregojnë edhe nevojën e rritjes së denoncimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare nga komuniteti. Nga ana tjetër këto gjetje reflektojnë nevojën për zbatimin e standardeve dhe respektimit të anonimatit të raportuesit/eses së dhunës në marrëdhëniet familjare.

PËRFAQËSIMI ME AVOKAT I VIKTIMËS SË DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Të dhënat nga monitorimi tregojnë se ofrimi i ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk përbën një të drejtë që viktimat e gëzojnë gjatë procesit të kërimit të mbrojtjes nga dhuna në familje. Kështu, viktimat e dhunës në familje nuk janë mbështetur nga një avokat në 95.3% të rasteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 100 % të rasteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Pogradec, në 71 % të rasteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në 97.9 % të rasteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në 86.7 % të rasteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Mendojmë se 23.3 % pa të dhëna në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, 1 % pa të dhëna në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës përbëjnë raste të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare të cilat nuk janë mbështetur me avokat. Këtë mendim e mbështesim në faktin se gjykatat e rretheve gjyqësore janë të vëmendshme në arësyetimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me përfaqësimin e palëve me avokat dhe nëse palët do të ishin përfaqësuar me avokat ky fakt do të reflektohej në vendimet gjyqësore. Nga monitorimi rezulton se viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë përfaqësuar me avokat nga organizatat jofitimprurëse që punojnë në rrethet e monitoruara në 21.4 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në 3.8 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 21 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në 1 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Është shqetësues fakti se duke mos pasur mundësi të gëzojnë mbështetjen ligjore falas në të gjitha rastet e monitoruara, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë mbështetur dhe përfaqësuar në proceset gjyqësore me avokat privat. Kështu në 2.9 % të rasteve viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë mbështetur me avokat privat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në 7.9 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në 0.9 % të rasteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në 13.3 % të rasteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Mungesa e ndihmës ligjore falas, mendojmë se përbën një nga barrierat kryesore për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor efektiv për viktimat e dhunës, të cilat lihen vetëm dhe pa mbrojtje ligjore. Ne kemi mendimin se mbrojtja me avokat falas do të ndikojë ndjeshëm në uljen e rasteve të pushimit të gjykimit, në marrjen e masave efikase, si dhe në respektimin e afateve të shpejta të këtij gjykimi.

Mbrojtja me avokat	Shkodër	Elbasan	Dibër	Vlorë	Pogradec	Durrës	Sarandë
Avokat OJF	21.4 %	3.8 %	-	21 %	-	1 %	-
Avokat privat	2.9 %	0.9 %	-	7.9 %	-	-	13.3 %
Avokat kryesisht	52.4 %	-	-	-	-	-	-
Nuk është mbrojtur me avokat		95.3%	100 %	71 %	100 %	97.9 %	86.7 %
Pa të dhëna	23.3 %	-	-	-	-	1 %	-

Tabela nr.8

Të dhënat që kanë rezultuar nga monitorimi tregojnë nevojën e një pune më të mirë për mbështetjen me shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare siç parashikon ligji nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. Për të bërë të mundur shërbimin ligjor falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kërkohet një zbatim më i mirë i ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", i ndryshuar përmes rolit të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike dhe kontraktimit nga ky Komision të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbim ligjor falas për viktimat. Kosto në kohë dhe para për aplikimin për shërbim ligjor falas mendojmë se duhet tja lërë vendin procedurave më të shpejta të kontraktimit nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Kjo do të mundësonte ofrimin e shërbimit ligjor falas për viktimat nga avokatë të organizatave jofitimprurëse jo vetëm profesionistë të mirë që garantojnë cilësinë e shërbimit ligjor por edhe avokatë të trajnuar për çështjet e dhunës me bazë gjinore, në mënyrë të veçantë dhunës në marrëdhëniet familjare.

Qasja e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime ligjore pranë Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike duke ngritur nevojën e ofrimit të këtij shërbimi të rëndësishëm për viktimat e dhunës në familje mendojmë se është mjaft e rëndësishme.

Gjithashtu, Agjencia për Mbështetjen e shoqërisë Civile mund të luajë një rol mjaft të rëndësishëm nëpërmjet mbështetjes së organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbim ligjor falas duke vendosur adresimin e dhunës në familje si një nga prioritetet dhe duke mbështetur këto organizata në kuadrin e projekteve të ndryshme.

Pavarësisht parashikimit ligjor se viktimat që paraqet kërkesë për urdhër mbrojtje në gjykatë shkarkohet nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave për shpenzimet gjyqësore si dhe ato të shërbimeve përmbartimore shtetërore, nevojitet marrja e masave nga shteti për ta garantuar këtë të drejtë efektivisht për viktimat.

KOHËZGJATJA E UM

Gjykatat e rretheve gjyqësore, në lidhje me kohëzgjatjen e UM kanë vendosur bazuar në specifikat e rastit. Nga monitorimi ka rezultuar një përqindje e lartë e vendimeve të UM, me efekt mbrojtje për viktimën e dhunës në familje në një muaj. Pra rezultojnë nga monitorimi 56 vendime gjyqësore me kohëzgjatje 1 muaj. Gjykata nuk heziton të lëshojë urdhër mbrojtje

për viktimat duke parashikuar masa të ndryshme mbrojtje por kohëzgjatja është minimale 1 muajore. Në 23 vendime gjyqësore ka rezultuar se kohëzgjatja e masave mbrojtëse është 6 muaj dhe në 19 vendime gjyqësore është 1 vit, duke treguar qartë se gjykatat e rretheve gjyqësore kanë vlerësuar drejt rrezikshmërinë që bart rasti i dhunës në familje.

Kohëzgjatja e UMM	Shkodër	Elbasan	Dibër	Vlorë	Pogradec	Durrës	Sarandë	Totali
1 muaj	3	2	-	-		50	-	56
2 muaj	1	-	-	-		-	4	5
3 muaj	1	5	1	-		2	2	11
4 muaj	-	-	-	-		-	1	1
6 muaj	1	10	5	3	1	1	2	23
9 muaj	-	-	1	-		-	-	1
12 muaj	2	2	3	4	5	-	3	19

Tabela nr. 9

ZBATIMI I AFATEVE PROCEDURIALE PËR LËSHIMIN E UMM/UM

Tabela në vijim na jep të dhëna mbi zbatimin e afateve procedurale për lëshimin e UMM/UM.

Afatet	Shkodër	Elbasan	Dibër	Vlorë	Pogradec	Durrës	Sarandë
Nr.	103	106	27	38	51	188	41
Afati 24/48 orë për lëshimin e UMM	Po/73 Jo/-	Po/38 Jo/-	-	Po /15 Jo/3 Pa të dhëna/16	Po/25 Jo/11	Po/13 Pa të dhëna/170	Po/11 Jo/12
Afati 20 ditë për vërtetimin e UMM	Po /24 Jo/-	Po/26 Jo/-	Po/8 Jo/11	Po/1 Jo/ -	-	-	Po/7 Jo/-
Afati 15 ditore për shqyrtimin/ ndërprerjen/ ndryshimin e UMM	Po/6 Jo/-	Po/42 Jo/-	Po/4 Jo/4	Po/2 Pa të dhëna /1	Po/2 Jo/13	Po /1 Pa të dhëna/4	-

Tabela nr.10

Nga monitorimi ka rezultuar se nuk janë respektuar afatet procedurale për lëshimin e UMM në 26 vendime gjyqësore në total. Në 186 vendime nuk kemi arritur të sigurojmë të dhëna nëse gjykata e ka zbatuar afatin 24 orë të lëshimit të UMM për viktimat e mitur dhe 48 orë

për viktimat madhorë . Vetëm në 11 vendime gjyqësore në Dibër nuk janë respektuar afatet procedurale në lidhje me vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, Pogradec dhe Sarandë nuk është respektuar afati i shqyrtimit nga gjykata të UM në 4 dhe 13 vendime gjyqësore respektivisht. Nuk kanë rezultuar të dhëna nga monitorimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Durrës në lidhje me afatin e shqyrtimit nga gjykata të UM në 1 dhe 4 vendime gjyqësore.

Moszbatimi i afateve procedurale nga gjykata sidomos në rastet e shqyrtimit të UMM sjellin pasoja të viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Gjykata duhet të marrë masa të menjëhershme me qëllim zbatimin e ligjit dhe afateve procedurale pasi zbatimi i tyre kontribuon në sigurinë e viktimave.

KU JANË BAZUAR GJYKATA E RRETHEVE GJYQËSORE NË DHËNIEN E VENDIMIT?

- ▶ Bindje e brendshme;
- ▶ Ligji;
- ▶ Prova;
- ▶ Fakte;

Nga monitorimi ka rezultuar se bazuar në ligj, bindjen e brendshme, prova dhe fakte gjykatat e rretheve gjyqësore kanë lëshuar UMM/UM. Konstatohet se në momentin e kalimit nga urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes në urdhrin e mbrojtjes ose në rastet kur viktimat i drejtohet drejtëpërdrejtë gjykatës për lëshimin e UM, gjykatat kanë kërkuar nga viktimat e dhunës në familje prova dhe kur viktimat nuk ka mundur ti sigurojë ato është vendosur rrëzimi i kërkesës.

Provat nuk duhet të përbëjnë një barrë për viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare. Rekomandimi i Komitetit CEDAW për Bullgarinë rekomandoi shtetin Bullgar 'të sigurojë që dispozitat në ligjin "Për mbrojtjen nga dhuna në familje" të lehtësojnë barrën e provës në favor të viktimës, duke amenduar ligjin në përputhje me rrethanat.' Për më shumë shih çështjen V.K kundër Bullgarisë³.

Në kuptimin e provave që vërtetojnë dhunën e ushtruar në marrëdhëniet familjare përfshihen edhe dokumenta të lëshuara nga punonjësit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë njësive vendore si edhe dokumenta të lëshuara nga persona juridikë, organizata jofitimprurëse të regjistruara sipas dispozitave në fuqi. Në këto kushte Zyrat e Shërbimeve Sociale pranë njësive vendore, ofj-të, si edhe anëtarë të Tjerë të Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në procesin e të provuarit.

PADIA PUBLIKE

Nuk rezulton asnjë rast që policia ose prokuroria të ketë paraqitur padi publike ndaj dhunesit, siç parashikohet në nenin 13 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në

³ V.K kundër Bullgarisë. CEDAË/C/49/D/20/2008. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, data e vendimit 25 Korrik 2011. Komunikimi 20/2008.

marrëdhëniet familjare", në lidhje me subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë urdhrin e mbrojtjes.

Kjo e drejtë që ligji kundër dhunës në familje i njeh policisë dhe prokurorisë, në lidhje me paraqitjen e kërkesës për urdhër mbrojtje për viktimën madhore nuk ka gjetur zbatim, duke bërë që të kemi një përqindje të lartë vendimesh pushimi si pasojë e mosparaqitjes së paditëses/it në proces ose heqjes dorë nga gjykimi të paditëses/it. Ushtrimi i të drejtës së padisë publike nga policia dhe prokuroria do të kontribuonte në rritjen e përgjegjësisë së dhunesëve për aktet e kryera sepse në rastet kur kërkesa paraqitet nga policia ose prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mos gjykimin e çështjes së filluar.

Të dhënat evidentojnë nevojën e vazhimit të trajnimeve për punonjësit e policisë dhe prokurorët me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për përdorimin e kësaj të drejtë të padisë publike e cila do të mundësonte mbrojtjen nga dhuna në familje, pavarësisht tërheqjes së viktimës.

Ende mbetet për të punuar për një rol më aktiv të Zyrave të Shërbimeve Sociale pranë bashkive dhe komunave dhe organizatave jofitimprurëse për të paraqitur kërkesë për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrin të mbrojtjes për të mitur.

MBROJTJA E TË MITURVE

Nga monitorimi reflektohet një rënie e numrit të rasteve të fëmijëve për të cilët kërkohet mbrojtje nga dhuna në familje, përmes paraqitjes së kërkesës për lëshimin e UMM/UM.

Në lidhje me mbrojtjen e të miturve nga dhuna ka rezultuar nga monitorimi i GJKATËS SË RREHIT GJYQËSOR SHKODËR se në 5 vendime gjyqësore është kërkuar mbrojtja e tyre përmes paraqitjes së kërkesës për lëshimin e UMM. Kërkesë paditë në të gjitha rastet janë bërë nga Komisariati i Policisë. Viktimat e mitur janë mbrojtur me avokat, nga shoqatat që merren me të drejtat e fëmijëve të cilat ofrojnë shërbime në Shkodër. Gjykata ka mbajtur parasysh kërkesat e ligjit duke caktuar ekspert psikolog. Aktorët nga të cilët kanë përfituar shërbim viktimat e mitur janë: policia, gjykata, organizatat jo fitimprurëse, shërbimi social.

Në GJKATËN E RREHIT GJYQËSOR ELBASAN vetëm në një rast është kërkuar mbrojtja e të miturve nga babai përmes paraqitjes së kërkesës për lëshimin e UMM/UM. Gjykata nuk ka mbajtur parasysh faktin që viktimat është e mitur dhe nuk ka caktuar psikolog duke mos përmbushur kërkesat e legjislacionit shqiptar. Ka qenë Komisariati i Policisë Librazhd i cili ka plotësuar kërkesë padinë dhe e ka dërguar në GJKATË. E mitura ka përfituar shërbim vetëm nga Komisariati i Policisë Librazhd; Gjykata Elbasan dhe Bashkia Librazhd.

Gjykata e RREHIT GJYQËSOR DIBËR ka gjykuar një çështje ku e mitura ka kërkuar mbrojtje nga dhuna fizike dhe psikologjike që ka ushtruar babai i saj. Gjykata ka zbatuar aftin 24 orë për shqyrtimin e kërkesës por çështja është pushuar pasi e mitura ka shkuar në seancë gjyqësore dhe ka kërkuar pushimin e gjykimit. Gjykata bazuar në legjislacionin procedural civil e ka pushuar padinë pasi është e drejta e paditësit të tërhiqet nga e drejta e tij e padisë. Ne mendojmë se kjo çështje kërkon vëmendje të vecantë jo vetëm nga Gjykata por nga të gjithë aktorët pasi cënon drejtpërdrejtë interesin më të lartë të të miturës dhe nuk i ofron mbrojtje nga dhuna e ushtruar kundrejt saj.

Në gjykatën e RREHIT GJYQËSOR VLORË ka rezultuar se është kërkuar mbrojtje për një të mitur nga nëna e saj përmes paraqitjes së kërkesës për lëshimin e UMM. E mitura është përfaqësuar nga nëna e saj, por vëmë re se Gjykata nuk ka caktuar psikolog gjatë zhvillimit të seancës

gjyqësore. Për tu nënvizuar është një nga masat që Gjykata ka lëshuar me qëllim që të ofrojë mbrojtje sa më efektive për viktimën dhe nënën e saj konkretisht Gjykata ka vendosur: *“urdhërimin e një punonjësi të Policisë të shoqërojë paditësen E.I (e mitura) dhe nëna e saj S.I deri në vendin e banimit dhe të punës dhe të mbikqyrë paditësen E.I dhe nënën e saj S.I.*

Nga monitorimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka rezultuar se kanë kërkuar mbrojtje dy viktima të mitura. Viktima e ka denoncuar dhunën në Policinë e Shijakut, e cila i ka hartuar kërkesë padinë për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Paditësja nuk është paraqitur vetë në gjykim dhe gjykata ka proceduar në mungesë të paditëses. Vendimi është vendosur ti komunikohet babait të saj si perfaqësuesi ligjor. E mitura ka qenë duke bashkjetuar me të paditurin dhe rezulton te kete patur konflikte të vazhdueshme gjatë bashkjeteses. Edhe pse paditësja nuk është paraqitur, i cili përbën shkak për pushim gjykimi Gjykata duke vlerësuar faktin që ka të bëjë me viktimë të mitur, rrezikshërinë e dhunuesit nuk ka hezituuar dhe ka lëshuar në mungesë të paditëses UMM.

Nuk ka rezultuar të përdoret ligji "për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" për mbrojtjen e të miturve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Sarandë.

Në rastin e mbrojtjes së të miturve duhet të luajnë një rol të rëndësishëm përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë dhe Komunës si edhe qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licensuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ish Ministria e Punës Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

ROLI I MEKANIZMIT TE KOORDINIMIT DHE REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Nga monitorimi është reflektuar edhe puna dhe kontributi i anëtarëve të Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje, në bashkitë Shkodër, Elbasan, Vlorë, Pogradec, Peshkopi, Durrës dhe Sarandë. Roli i Koordinatorit vendor pranë bashkive ka konsistuar në referimin e viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare në polici, gjykatën e rrethit gjyqësor, organizatat jofitimprurëse me qëllim mbrojtjen e viktimës dhe rehabilitimin e saj përmes ofrimit të shërbimeve nga organizatat jofitimprurëse të specializuara që punojnë në këtë fushë. Kështu ka rezultuar se viktimat e dhunës në familje kanë përfituar:

- ▶ Shërbime të ofruara nga organizatat jofitimprurëse;
- ▶ Këshillime Psikologjike;
- ▶ Këshillime Ligjore;
- ▶ Përfaqësim të rastit në gjykatën e rrethit gjyqësor;
- ▶ Akomodim;
- ▶ Kurse profesionale;
- ▶ Punësim;

Policia, gjykatat e rretheve gjyqësore, organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e dhunës në familje, janë ndër aktorët më aktivë të këtij Mekanizmi.

Roli i Koordinatorit vendor të këtij Mekanizmi ka rezultuar mjaft aktiv në rrethet Shkodër, Elbasan, Pogradec. Mendojmë se kjo gjetje reflekton punën e OJF-ve në mbështetje të

viktimave dhe sa aktivë ato e shohin Koordinatorin vendor. Për të konkluduar në lidhje me këtë element mendojmë se do të nevojitej shoqërimi i monitorimit të vendimeve gjyqësore me tregues të tjerë matës. Duhet të konsiderojmë edhe burimin e gjetjeve, monitorimin e vendimeve gjyqësore burim i cili duhet shoqëruar me burime të tjera për të hedhur dritë mbi punën dhe efektivitetin e aktivitetit të Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje.

Në vijim po japim të dhëna të detajuara që kanë rezultuar nga monitorimi mbi punën e Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkitë Elbasan, Durrës, Pogradec, Vlorë, Peshkopi, Sarandë dhe Shkodër.

MKR ELBASAN DHE ROLI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Nga vendimet e monitoruara, në 4 raste rezulton se viktimat ka përfituar shërbim nga Koordinatorin vendor dhe nga Komuna. Të dhënat në tabelën si më poshtë vijon:

Koordinatori vendor		
	Numri	Në %
Ka përgatitur një procesverbal referimi	2	100 %
Komuna Papër përgatiti një relacion për situatën e viktimës	1	
Koordinatori vendor ka referuar rastin në polici dhe tek FGE. Ka përgatitur një procesverbal referimi	1	
Nuk ka të dhëna	102	
Totali	106	

Tabela nr.11

Na ka rezultuar nga monitorimi se viktimat e dhunës në familje ka përfituar shërbim edhe nga aktorët e tjerë të mekanizmit si Policia, Gjykata, Oj. Në lidhje me mekanizmin dhe mënyrën e funksionit të tij në Bashkinë Elbasan avokatet e FGE na kanë sqaruar si më poshtë vijon:

Mekanizmi i referimit funksionon vetëm në Bashkinë Elbasan (ku deri para hyrjes në fuqi të ndarjes së re territoriale ishin përfshirë dhe 5 Komunat, Shirgjan, Shushice, Tregan, Gjergjan dhe Paperr). Mekanizmi është ngritur bazuar në VKM-në vitin 2011, është krijuar Komiteti Drejtues i cili drejtohet nga Kryetari i Bashkisë bashkë me përfaqësuesit e institucioneve publike dhe 3 OJF lokale. Komiteti mbledhet një herë në tre muaj, në të cilin shqyrtohet rastet e viktimave të dhunës në familje, gjithashtu pjesë e mekanizmit është dhe ekipi teknik që mbledhet një herë në muaj, po me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe 3 OJF. Rastet e shqyrtuara në ekipin teknik me pas prezantohen në Komitetin Drejtues.

Për ekzekutimin e vendimit koordinatori vetëm ndjek procedurën e dhenies së ndihmes ekonomike. Në komunat dhe bashkitë e tjera të Qarkut Elbasan nuk ka koordinator vendor, vetë viktimat shkon dhe aplikon në komune për ndihmë ekonomike.

Nga rastet e monitoruara koordinatori nuk është thirrur asnjehere nga Gjykata.

Nga rastet e monitoruara janë përdorur relacionet e koordinatorit në Gjykatë si prova vetëm në rastet e grave të cilat janë mbrojtur nga Studio Avokatore e Forumit të Gruas Elbasan, gjithsej 2.

Tabela sqaron në mënyrë të detajuar shërbimet që ka përfituar viktimat.

Aktorët që ka marr vikima shërbim		
	Numri	Në %
Koordinator vendor	3	
Policia/ Gjykata	77	39.4%
Gjykata	2	41.13%
Komisariatit e Policisë Elbasan; Koordinatori vendor, Gjykata, Forumi i Gruas Elbasan/FGE (OJF)	1	
Komisariatit e Policisë Elbasan; Forumi i Gruas Elbasan (u akomodua tek Qendra e Kujdesit Ditor dy ditë), Gjykata;	5	
Forum i Gruas Elbasan, Komisarati i Policisë Elbasan, Gjykata	2	19.45%
Komisariatit e Policisë Elbasan; Komuna Papërr; Gjykata, Forumi i Gruas Elbasan (FGE) (është strehuar në Qendrën e Kujdesit Ditor, shërbim i FGE-së)	1	
Komisariatit e Policisë; Gjykata Elbasan; Komunw	9	
Komisariatit e Policisë Elbasan; Gjykata Elbasan; Bashkia Elbasan	6	
Komisariatit e Policisë Tiranë; Strehëza kombëtare e vitimave të dhunë Tiranë; Gjykata Elbasan	1	

Tabela nr.12

Shërbimet falas që kanë përfituar viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nga Forumi i Gruas Elbasan janë shërbim ligjor falas, psikologjik, akomodin dhe shpenzimet gjyqësore për procesin e zgjidhjes së martesës.

Tabela në vijim na jap të dhëna të detajuara në lidhje me këto shërbime.

Shërbimet që ka përfituar falas nga FGE	
	Numri
Këshillime psikologjike	8
Hartim kërkesë padi	8
Këshillim ligjor	8
Përfaqësim në gjykatë	8
Strehim	8
Shërbim ligjor dhe psikologjik falas në procesin e zgjidhjes së martesës	7
Pagesë e shpenzimeve gjyqësore	7

Tabela nr.13

Përfitimi i ndihmës ekonomike nga viktimat e pajisur me UMM/UM

Në 37 raste viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare ka përfituar ndihmë ekonomike në bazë të VKM nr.787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike”. Viktimat është ndihmuar nga koordinatori vendor për të përfituar ndihmën ekonomike.

ROLI I MEKANIZMIT TE KOORDINIMIT DHE REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE OJF-VE PESHKOPI

Nga vendimet e monitoruara, konstatohet se viktimat është mbështetur nga organi i policisë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër në 100 % të rasteve.

Aktorët që kanë mbështetur viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare

Aktorët që kanë ofruar shërbim për viktimat		
	Numri	Në %
Policia	27	100 %
Gjykata	27	100 %

Tabela nr.14

ROLI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Viktimat nuk kanë përfituar asnjë shërbim falas nga organizatat jofitimprurëse.

Roli i organizatave jofitimprurëse

Nuk janë konstatuar raste të përfitimit nga viktimat të shërbimeve të ofruara nga organizatat jofitimprurëse.

ROLI I MEKANIZMIT TE KOORDINIMIT DHE REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE SHKODËR DHE ROLI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare ka përfituar shërbime nga policia, gjykata, ofj. Avokatet e gruaja te gruaja Shkodër na sqarojnë se kanë bashkëpunim shumë të mirë me

gjykatën. Gjykata në vijimësi bashkëpunon me ofj të cilat ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës madhorë dhe të mitur. GjRrGj Shkodër ka referuar 17 raste për të përfituar shërbim ligjor falas nga GtG.

Tabela në vijim na jep të dhëna mbi rolin aktivë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, policisë, dhe organizatave jofitimprurëse si anëtarë të këtij Mekanizmi.

Aktorët që kanë ofruar shërbim për viktimat		
	Numri	%
Koordinatori vendor	-	
Policia	39	37.9 %
Gjykata	22	21.4 %
Policia/gjykatë	14	13.6 %
Gjykate dhe OJF	2	1.9 %
Polici/gjykate/ojf	7	6.8 %
Ojf	1	1 %
Pa të dhëna	18	17.5 %

Tabela nr.15

Shërbimet e përfituara nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë këshillime psikologjike, ligjore dhe përfaqësimi i rasteve në gjykatë.

Të dhëna të detajuara mbi shërbimet na jep tabela në vijim.

GtG	Numri
Këshillime psikologjike	11
Shërbim ligjor falas	13

Tabela nr.16

ROLI I MEKANIZMIT TE KOORDINIMIT DHE REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË VLORË

Nga vendimet e monitoruara, konstatohet se viktima ka marrë shërbime nga OJF-të në 21 % të rasteve. Në të gjitha vendimet objekt monitorimi ka rezultuar mbështetja e policisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu në një rast ka rezultuar edhe mbështetja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve Bashkia Vlorë.

Aktorët që kanë ofruar shërbim për viktimën

	Numri
Koordinator vendor	-
Policia,Gjykate, ojf Vatra, Njesia per Mbrojtjen e Femijeve Bashkia Vlore	1
Gjykata	38
Gjykate, ojf Vatra	1
Polici/gjykate	19
Polici, gjykate, ojf Vatra	6

Tabela nr.17

Shërbimet falas që kanë përfituar viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nga Qendra Psiko Sociale Vatra Vlore janë këshillime psikologjike, këshillime ligjore, përfaqësime të rasteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, akomodim, kurse të formimit profesional dhe punësim. Tabela në vijim na jap të dhëna të detajuara në lidhje me këto shërbime.

Shërbimet falas të ofruara nga Qendra Psiko Sociale Vatra Vlorë	Numri
Këshillime psikologjike	8
Këshillim ligjor	8
Përfaqësime në Gjykatë	8
Mbeshtetje psiko-sociale	5
Ndërmjetësim për punësim	2
Ofrim i kurseve profesionale	3
Punësim	1
Ndërmjetësim per perfitimin e ndihmes ekonomike si viktime e dhunes ne familje	2
1 perfituese po vleresohet per ngritjen e nje mikrobiznesi parukerie	1
Ofrim i kurseve profesionale	3
Shoqerim ne Qendren Kombetare te dhunes	2

Tabela nr.18

Roli i Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje Pogradec dhe roli i organizatave jofitimprurëse

Aktorët që kanë ofruar shërbim për viktimën		
	Numri	Në %
Koordinator vendor	-	
Policia	51	100 %
Gjykata	51	100 %
Totali	51	100 %

Tabela nr.19

Nga vendimi nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me rolin e Koordinatorit Vendor, pranë Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Dy aktorët e këtij mekanizmi organi i policisë dhe gjykata e rrethit gjyqësor kanë mbështetur të gjitha rastet objekt monitorimi.

Në lidhje me shërbimet falas të përfituara nga viktimat, ka rezultuar se në 23.8 % të rasteve, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë përfituar këshillime psikologjike dhe informim mbi LDH nga “Unë, Gruaja”.

Të dhëna në lidhje me shërbimet që ka përfituar falas viktimat

Shërbimet që ka përfituar falas viktimat		
	Numri	Në %
Këshillime psikologjike	12	23.8 %
Këshillim mbi LDH	12	23.8 %

Tabela nr.20

Komente për zbatimin e ligjit;

Një nga avokatet që përfaqëson rastet e dhunës në familje sqaron se viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk përdorin mjetet ligjore mbrojtëse që ofron LDH por i drejtohen gjykatës me kërkesë padi për zgjidhje martese pasi ndihen të frikësuara nga reagimet që mund të kenë bashkëshortët nëse ato denoncojnë dhunën. Gjithashtu viktimat përballen me problematika të shumta pasi mungon shërbimi ligjor falas. Problematikat shtohen edhe më shumë në rastet kur gjykata ka vendosur që bashkëshorti dhunues duhet të largohet nga shtëpia dhe duke qenë se nuk ka një banesë tjetër kjo e vështirëson situatën dhe shton problematikat dhe shpesh herë edhe dhunën. Në vitin 2015 ka qenë vet Gjykata që ka denoncuar dhunën në Gjykatën penale pasi ka vënë re se një grua kishte shenja dhune të dukshme gjatë procesit gjyqësor të lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në këtë rast viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare ka shkuar te organet kompetente dhe ka kërkuar që kjo çështje të përfundonte por përfundimisht gjykata penale e dënoi dhunuesin sipas parashikimeve të legjislacionit penal.

Roli i Mekanizmit te Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje, Durrës dhe roli i organizatave jofitimprurëse

Referimi per ekzekutim	Shkodër	Elbasan	Dibër	Vlorë	Pogradec	Durrës	Sarandë
------------------------	---------	---------	-------	-------	----------	--------	---------

Nuk rezultojnë të dhëna nga monitorimi në lidhje me rolin e Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje si edhe në lidhje me shërbimet që ofrohen nga organizatat jofitimprurëse në Durrës.

Roli i Mekanizmit te Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje Sarandë

Nga vendimet e monitoruara, konstatohet se viktimat është mbështetur në të gjitha rastet objekt monitorimi nga policia dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Aktorët që kanë ofruar mbështetje për viktimën

Aktorët që kanë ofruar mbështetje për viktimën		
	Numri	Në %
Koordinator vendor	-	
Policia	26	86.7 %
Gjykata	30	100 %
Totali	30	100 %

Tabela nr.21

Forcimi i Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të Rasteve të dhunës në familje dhe zgjerimi i këtij mekanizmi me komuna përbën një nevojë që do të adresonte edhe rastet në rritje të dhunës në marrëdhëniet familjare në zonat rurale.

REFERIMI I VENDIMIT TË UMM/UM PËR EKZEKUTIM

Zyrë përmbarimi/ Komisarati i Policisë/ Z.Sherb Sociale	103		27	15	6	188	19
Komunë/Prokurori/ Zyrë përmbarimi/ Komisarati i Policisë					2		
Zyrë përmbarimi/ Komisarati i Policisë/ Z.Sherb Sociale/ Prokurori					4		
Komisarati i Policisë		79		1			4
Komisarati i Policisë dhe Z.Sherb Sociale		62		22			1
Koordinatori vendor		1					
Komisarati i Policisë dhe Z.përmbarimi							1
Nuk ka të dhëna		39			39		5

Tabela nr.22

Tabela në vijim na jep të dhëna të detajuara në lidhje me referimin e vendimeve të lëshimit të UMM/UM për ekzekutim, sipas gjykatave të rretheve gjyqësore. Nga tabela vihet re qartë që gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi nuk kanë zbatuar si duhet ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar në lidhje me referimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes për ekzekutim. Ky ligj parashikon rolin e Zyrës së Përmbarimit, Komisarateve të Policisë dhe njësive të qeverisjes vendore për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes.

KREU I III-KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione:

1. Monitorimi tregoi qartë se Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar është zbatuar me efektivitet në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Elbasan, Durrës, Dibër, Sarandë, Pogradec dhe Vlorë duke parandaluar dhunën në marrëdhëniet familjare. Marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes që kërkojnë mbrojtje nga dhuna janë shumë të larmishme në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi.
2. Profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është në përqindjen më të lartë të rasteve një grua, e paarsimuar, e papunë dhe që përballet me forma të ndryshme të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhuna fizike, dhuna psikologjike, dhuna e kombinuar, e asistuar etj. Karakteristika të tjera të profilit social të viktimës që lidhen me vendbanimin, moshën, numrin e fëmijëve janë të ndryshme në rrethet objekt monitorimi.
3. Arsimi i ulët, papunësia janë karakteristika të përbashkëta për profilin social të dhunuesëve në gjykatat objekt monitorimi.

Alkooli, xhelozia, shpenzimi i kohës dhe parave në lojërat e fatit, mosmarrëveshjet për shkak të çështjeve pasurore dhe çështjeve të pronësisë; jetesa e përbashkët e ish-bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës, mosmarrëveshjet dhe konfliktet familjare që shoqërojnë marrëdhëniet në familje, personaliteti i dhunshëm dhe gjendja psikologjike e rënduar e dhunuesit e shoqërojnë dhunën në marrëdhëniet familjare dhe kërkojnë një vëmendje të veçantë.

4. Monitorimi dëshmoi nevojën e garantimit të shërbimit ligjor falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, pasi u konstatuan një përqindje e rasteve të pambështetura me avokat ligjor falas ose të mbrojtura me avokat privat.

5. Policia dhe prokuroria nuk kanë përdorur të drejtën që u njeh ligji për paraqitjen e kërkesës për urdhër mbrojtje për një viktimë madhore.

6. Policia në disa nga rrethet gjyqësore ka shoqëruar viktimën në rastet kur ka vlerësuar se jeta e saj është në rrezik.

7. Persona të tretë të dëmtuar në marrëdhëniet familjare rezultojnë fëmijët, por përqindja e rasteve që kërkojnë mbrojtje për fëmijët përmes kërkesës për lëshimin e UMM/UM është mjaft e ulët. Rezultoi se subjektet e ngarkuara nga ligji për të mbrojtur të drejtat e të miturve nga dhuna në marrëdhëniet familjare nuk i kanë ushtruar këto të drejta në favor të fëmijëve.

8. Format e dhunës fizike, psikologjike, ekonomike të kombinuar dhe asistuar janë disa nga format e dhunës me të cilat përballen viktimat në marrëdhëniet familjare.

9. Roli i organizatave jofitimprurëse në nivel lokal është shumë i rëndësishëm për menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat në nivel lokal. Shërbimet e ofruara nga organizatat jofitimprurëse në rrethe kanë forcuar viktimat dhe i kanë bërë ato më të motivuara të përdorin mjetet ligjore ekzistuese.

10. Përqindja e lartë e vendimeve të pushimit kërkon një punë më të koordinuar dhe efektive të aktorëve përgjegjës, anëtarë të Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje, me qëllim rritjen e besimit të viktimave tek këto organe.

11. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore kanë referuar vendimin e lëshimit të UMM për zbatim në organin e policisë dhe/ose në Zyrën e Përmbartimit dhe/ose në Zyrën e Shërbimeve Sociale pranë bashkive dhe komunave, duke mos respektuar detyrimin që ligji parashikon për të tre këto organe për zbatimin e UMM/UM.

12. Gjykimet në përgjithësi janë zhvilluar në afatet e parashikuara në ligj dhe në disa raste nuk janë respektuar afatet në rastet e UMM, vërtetimit të UMM ose lëshimit të UM.

13. Raporti monitorues reflekton një përmirësim të punës së gjykatave të rretheve gjyqësore në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar përmes dhënies së vendimeve të shpejta për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Rekomandime:

- Të forcohet koordinimi dhe efektiviteti i punës së anëtarëve të Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare me qëllim rritjen e besimit të viktimave në aktorët përgjegjës. Ky reagim i koordinuar është i nevojshëm jo vetëm në procesin e paraqitjes së kërkesës në gjykatat e rretheve gjyqësore për lëshimin e UMM/UM por edhe në zbatimin e UMM/UM nga Zyrat e Shërbimeve Sociale pranë bashkive dhe komunave, Komisaritet e Policisë dhe Zyrat e Përmbarrimit.
- Të monitorohet në vijimësi puna e aktorëve, të rritet roli i Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në procesin e të provuarit të dhunës në marrëdhëniet familjare, duke lehtësuar barrën e viktimave për t'i paraqitur gjykatës prova për dhunën e pësuar.
- Të përmirësohet puna për monitorimin e aktorëve të Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Është mjaft e rëndësishme të përmendim faktin se çështja e strehimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare është ende e pazgjidhur, edhe në rastet e mirëfunksionimit të MKR-së.
- Bashkitë dhe komunat të zgjidhin efektivisht çështjen e strehimit të viktimave të dhunës në familje dhe t'i japin prioritet këtij target grupi për akomodim në banesa sociale.
- Të hartohet një përshkrim pune i detajuar për Koordinatorin lokal për çështjet e dhunës në familje.
- Të rritet ndërgjegjësimi dhe niveli i informacionit të punonjësve të institucioneve të Policisë dhe Prokurorisë të cilët asistojnë viktimat e dhunës në familje për paraqitjen e padisë publike dhe rëndësinë e përdorimit të kësaj të drejte.
- Të rritet roli i zyrave të shërbimeve sociale në bashki dhe komuna në paraqitjen e kërkesave për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe kërkesave për urdhër mbrojtje jo vetëm për të mitur.
- Të rritet roli i zyrave të shërbimeve sociale në bashki dhe komuna paraqitjen e informacionit për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në Gjykatë.
- Të ndërmerren hapa me qëllim përmbushjen e detyrimit që parashikon ligji për Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, për paraqitjen pranë Gjykatave të listës së avokatëve kryesisht, me qëllim ofrimin e shërbimit ligjor falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Të forcohet mbështetja për organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime ligjore falas nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile me qëllim rritjen e numrit të përfituesëve, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të mbështetura me shërbim ligjor falas.
- Të ngrihen Qendra rehabilitimi për dhunuesit të cilët në një përqindje të lartë të rasteve janë konsumues të alkoolit, kanë një personalitet të dhunshëm, kane varësi ndaj lojrave të fatit, etj.

- Pushteti qëndror e lokal të ofrojë mbështetje financiare të qëndrueshme për organizatat që asistojnë viktimat e dhunës në familje me shërbime komunitare e rezidenciale.
- Të hartohen dhe implementohen programe punësimi efektive për viktimat e dhunës në familje me qëllim fuqizimin ekonomik të këtij target grupi.
- Të vazhdojë trajnimi për aktorët që asistojnë viktimat e dhunës në familje dhe kanë detyrim të zbatojnë legjislacionin ekzistues në këtë fushë.
- Gjykatat të përfshijnë shërbimet sociale në urdhrat e mbrojtjes duke urdhëruar ndërhyrjen e tyre me qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje (në zbatim të nenit 10/k të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”).

Literatura:

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ratifikuar me ligjin nr.104/2012

Ligje:

1. Ligj Nr. 10 329, datë 30.9.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 ‘Për

masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, i ndryshuar”.

2. Ligj nr.10039, dt. 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”.

Raporte:

Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2009. (botuar në ëebsite: [http//ëëë. qag-al.org](http://ëëë.qag-al.org)).

Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” për periudhën e monitorimit 01.06.2009-01.06.2010, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2011, (botuar në ëebsite: [http//ëëë. qag-al.org](http://ëëë.qag-al.org)).